



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLICA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPK</u>	Nr. Prot. <u>03-02/476/16</u>
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/476/16</u>
Nr. l faq.	Data <u>04.11.2016</u>
Broj stranica	Datum <u>04.11.2016</u>
Nr. pages	Date <u>04.11.2016</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3360/16, për znj. Afërdita Bicurri, Drejtore e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Gjakovë, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Afërdita Bicurri, Drejtore e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Gjakovë, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Bicurri është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga funksioni menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, znj. Bicurri, ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4047/16), me të cilën vërtetohet se zyrtarja e lartë ka heq dorë nga funksioni menaxherial në biznesin privat L.M “Mikrolab”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

